

JUXHINA SPAHIU

I komanduar në detyrë, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Juxhina Spahiu ushtron detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) që prej janarit 2026, krahas detyrës si Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Projekteve në AKZM pranë Ministrisë së Mjedisit.

Me formim në arkitekturë dhe studime të avancuara në Barcelonë në fushën e ndërhyrjeve në peizazh dhe menaxhimit të trashëgimisë, znj. Spahiu sjell në drejtimin e AKZM-së një profil ndërdisiplinor që ndërthur planifikimin territorial, menaxhimin e peizazhit dhe ruajtjen e vlerave natyrore e kulturore. Gjatë periudhës së saj në Barcelonë, ajo është angazhuar në studimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, me fokus të veçantë në kontekstin mesdhetar, ku ka punuar edhe si Koordinatorë pranë një qendre kërkimore të Universitetit Autonom të Barcelonës, ku ka bashkëpunuar me institucione ndërkombëtare dhe aktorë të ndryshëm.

Më parë, znj. Spahiu ka mbajtur pozicion menaxherial pranë BALFIN Group, ku është angazhuar në drejtimin dhe koordinimin e disa prej projekteve më të rëndësishme të kompanisë, veçanërisht në fushën e zhvillimit dhe menaxhimit të projekteve.